



**Zgjedhjet e jashtëzakonshme komunale të 20 gushtit 2022 në
Tetovë: një tërmet lokal me valë tronditëse në nivel shteti**

Përgatitur nga:
IPP ARBEN XHAFERI

Gusht, 2022



Hyrje

Të shtunën më 20 gusht, tetovarët u janë drejtuar qendrave të votimit për zgjedhjet e jashtëzakonshme për anëtarët e këshillit komunal për pjesën e mbetur të mandatit (2024).

Ndërsa Maqedonia e Veriut po përballlet me kriza të shumta dhe gjasat për zgjedhje të parakohshme parlamentare janë gjithnjë e më të mëdha, zgjedhjet e Tetovës shiheshin si një test i disponimit negative të votuesve ndaj një qeverie të diskredituar, siç është sugjeruar shpesh nga sondazhet e fundit.

Konteksti: polarizimi ekstrem i skenës politike republikane pasqyrohet në nivelin lokal

Zgjedhjet e rregullta lokale në Maqedoninë e Veriut u mbajtën më 17 dhe 31 tetor 2021. Në Tetovë, lideri i Lëvizjes Besa, Bilall Kasami, fitoi me lehtësi garën për kryetar komune në rrethin e dytë me 54,84% përballë kryetares në largim Teuta Arifi (Bashkimi Demokratik për Integrim), mes skandaleve të shumta korruptive dhe zemërimit popullor lidhur me mungesën totale të llogaridhënies pas tragjedisë së Tetovës të shtatorit 2021, kur 14 qytetarë humbën jetën në flakët e klinikës modulare Covid.

Pavarësisht humbjes së garës për kryetar komune, Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) fitoi zgjedhjet për këshillin komunal me 26,37% dhe 10 këshilltarë, ndërsa Besa u rendit e dyta me 21,82% dhe 8 këshilltarë. Më 18 nëntor 2021, Kasami formoi koalicion me forcat opozitare VMRO-DPMNE (4), Aleancën për Shqiptarët (3) dhe Iniciativën Qytetare “Më mirë për Tetovën” (2), duke siguruar një shumicë të ngushtë (17) në këshillin 31 anëtarësh.

Paralelisht, në nivelin qendror po ndodhnin zhvillime dramatike, me tensione në rritje mes BDI-së dhe Besës, dy partnerët kryesorë shqiptarë të koalicionit të udhëhequr nga SDSM:

- Ndërsa OSBE-ODIHR dhe vëzhguesit lokalë kishin konstatuar manipulime të gjera zgjedhore, frikësim dhe blerje votash nga partitë në pushtet, përfshirë BDI-në, kjo e fundit gjithashtu tregoi tendenca të qarta për manipulim të autoriteteve gjyqësore dhe administrative për të rikthyer komunat e humbura në votim të rregullt, veçanërisht komunën e Zhelinës e udhëhequr nga Besa që nga zgjedhjet lokale të 2017.
- Një nga rezultatet kryesore të zgjedhjeve lokale të vitit 2021 ishte dorëheqja e kryeministrit Zoran Zaev, pas humbjes së rëndë të partisë së tij kundër VMRO-DPMNE-së, e cila fitoi shumicën dërrmuese të komunave me shumicë maqedone. Fundi i epokës Zaev erdhi gjithashtu si rezultat i bllokadës së proceseve integruese për shkak të vetos së vazhdueshme bullgare për hapjen e bisedimeve për anëtarësimin e Maqedonisë e Veriut në BE, si dhe bilanit katastrofik të Zaevit në skenën e brendshme – mungesë e zbatimit të reformave, korrupsion dhe kriminalitet galopant, si dhe skandalet të përditshme si tragjedia e spitalit të Tetovës dhe tragjedia e autobusit Besa Trans në Bullgari për të cilat askush nuk ka dhënë llogari. Në përgjithësi, ishte bërë e qartë se erërat ishin kthyer nga LSDM drejt VMRO-DPMNE në kampin maqedonas, me këtë të fundit në kurs të mirë për të formuar qeverinë e ardhshme.

Në këtë kontekst, Besa, e cila kishte garuar në listë të përbashkët me SDSM në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2020, ndërroi krah dhe mbështeti opozitën në dorëzimin më 11 nëntor 2021 të një mocioni mosbesimi të mbështetur nga 61 deputetë nga gjithsej 120 sa ka Kuvendi. Megjithatë, një nga deputetët më të zëshëm të opozitës dhe ndër nënshkruesit e parë të mocionit, Kastriot Rexhepi

(Besa), u zhduk pak para votimit dhe publikoi një mesazh video më vonë gjatë ditës për të arsytuar tërheqjen e tij nga mocioni. Nga shumëkush, kjo u pa si një rast shkollor i shantazhimit dhe blerjes së deputetëve nga koalicioni qeverisës SDSM-BDI dhe strukturat shtetërore të sigurisë.

Pas mocionit të dështuar të mosbesimit, Besa u largua zyrtarisht nga qeveria më 9 dhjetor dhe u zëvendësua nga Alternativa, një parti që origjinon nga një ndarje brenda Besës dhe deri atëherë ishte në një koalicion parazgjedhor me Aleancën për Shqiptarët, me 4 deputetë Brenda grupit të përbashkët parlamentar 12 anëtarësh. Më 16 janar 2022, Kuvendi votoi për një riorganizim të qeverisë, tanimë e udhëhequr nga ish-zëvendësministri i financave Dimitar Kovaçevski (SSDM) dhe e përbërë nga SDSM, BDI, Alternativa dhe Partia Demokratike Shqiptare (PDSH), me gjithsej 64 deputetë.



Bllokada e këshillit komunal të Tetovës dhe zgjedhjet e jashtëzakonshme: çfarë ishte në lojë?

Me ardhjen e Kasamit si kryetar komune, ajo që ndodhi në Tetovë në thelb është bartja e tensioneve të nivelit qendror në jetën e komunës.

Kasami e filloi mandatin me akuza të forta ndaj ish-kryetares nga BDI-, Teuta Arifi, duke e fajësuar atë për keqmenaxhim që çoi në një borxh publik në vlerë prej 24 milionë euro – buxheti vjetor i Tetovës është rreth 27 milionë euro – dhe në ngrirjen e llogarive bankare komunale. Po ashtu, Kasami ka ngritur disa raste në prokurorinë publike kundër Arifit për shpërdorim detyre lidhur me kontrata fiktive të punës, shpronësime dhe tenderë për infrastrukturë publike. Nuk është ngritur ende ndonjë aktakuzë ndaj Arifit, ndërsa është raportuar se SHBA, BE dhe Turqia e kanë refuzuar emrin e saj si ambasadore e propozuar nga Maqedonia e Veriut në ato vende.

“TETOVA ËSHTË KOMUNA E TRETË MË E MADHE NË VEND ME GATI 85,000 BANORË. DUKE PASUR PARASYSH STATUSIN E SAJ SI KRYEQENDRA E SHQIPTARËVE NË MAQEDONINË E VERIUT, TETOVA VENDOS TRENDËT NË JETËN POLITIKE SHQIPTARE NË VEND.”

BDI u përgjigj me kundërakuzat për keqpërdorime me kontrata të punës dhe tenderë publikë, duke shfrytëzuar udhëheqjen e saj të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për të pezulluar kompetencat e Kasamit në emërime, avancime dhe transferime të nëpunësve publikë.

Këto tensione, të shoqëruara me transferime të këshilltarëve mes BDI-së dhe Besës, si dhe promovimi i një këshilltari të Besës në ekzekutiv dhe moszëvendësimi i tij në këshill, e dobësuan shumicën e brishtë të Kasamit. Si pasojë, këshilli komunal nuk arriti të miratojë llogarinë buxhetore për vitin 2021 deri më 31 mars, siç parashihet në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale.

Pas një loje ping-pongu disajvare midis nivelit qendror dhe komunës së Tetovës, qeveria shpërnda këshillin e Tetovës më 14 qershor. Një javë më vonë, kryeparlamentari Talat Xhaferi miratoi vendimin e qeverisë dhe shpalli mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për këshillin komunal të Tetovës më 20 gusht.

Vlen të theksohet se edhe komunat Mavrovë-Rostushë dhe Qendër Zhupa po ktheheshin në qendrat e votimit më 20 gusht pasi që kërkesa ligjore për pjesëmarrje prej së paku një të tretës të numrit të përgjithshëm të votuesve të regjistruar nuk ishte përmbushur në këto komuna në vitin 2021.

Implikimet e zgjedhjeve të Tetovës ishin të shumta dhe të gjera.

Tetova është komuna e tretë më e madhe në vend me gati 85,000 banorë sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2021. Duke pasur parasysh statusin e saj si kryeqendra e shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, Tetova vendos trendet në jetën politike shqiptare në vend. Për më tepër, Tetova është shtëpi e një numri të konsiderueshëm të qytetarëve maqedonas që përbëjnë rreth një të tretën e popullsisë komunale, dhe për këtë arsye ajo është një fushë beteje e rëndësishme edhe për partitë maqedonase.

Ndërsa gjasat për zgjedhje të parakohshme parlamentare janë të mëdha, zgjedhjet e 20 gushtit në Tetovë shiheshin si një test kritik për të gjitha forcat politike në vend në dhe si parapërgatitje për fushatën e ardhshme republikane:

- Për Besën e Kasamit, këto zgjedhje ishin mundësia për të siguruar një shumicë të fortë për pjesën e mbetur të mandatit komunal, por ndoshta më e rëndësishmja, për t'u pozicionuar si një forcë serioze e opozitës shqiptare, e aftë për të çrrënjësuar BDI-në, e cila ka pothuajse dy dekada pa ndërprerje në pushtet.
- DUI on its hand was aiming to prevent Kasami from being able to efficiently run the municipality and further grow his party from his stronghold. DUI was also testing its newly elected local leadership, breaking away from a corrupt old guard gravitating around Teuta Arifi and other DUI founders.
- BDI në anën tjetër synonte të pengonte Kasamin për të drejtuar komunën me efikasitet dhe rritur më tej partinë nga tanimë bastioni i tij. BDI po testonte gjithashtu udhëheqjen e saj të sapozgjedhur lokale, që sinjalizonte shkëputje nga një gardë e vjetër e korruptuar që graviton rreth Teuta Arifit dhe themeluesve të tjerë të BDI-së.
- Autsjajderi kryesor i këtyre zgjedhjeve ishte pa dyshim Aleanca për Shqiptarët (ASH), partia më e madhe opozitare shqiptare, e cila rishtas kishte zgjedhur lidërshtipin e saj të ri, si në nivel lokal ashtu edhe në atë qendror, përfshirë një sekretare të përgjithshme nga Tetova. Prandaj, këto zgjedhje ishin një provë vendimtare për ASH-në për të konfirmuar lidërshtipin e saj të ri dhe pozicionin e saj si forca kryesore opozitare në kampin shqiptar.
- On the Macedonian side, Kovacevski's SDSM was running mostly to limit damage in light of an increasingly hostile Macedonian public opinion. All recent national level polls have been calamitous for SDSM following the endorsement in Parliament of the French proposal to lift Bulgarian veto on EU accession talks, perceived as a threat to Macedonian national identity, and a disastrous track record in internal politics, at all levels.
- Nga ana maqedonase, SDSM e Kovaçevskit po garonte kryesisht për të limituar dëmet përballë një opinionin publik maqedon gjithnjë e më armiqësor. Të gjitha sondazhet e fundit në nivel republikan kanë qenë katastrofike për SDSM-në pas miratimit në Kuvend të propozimit francez për heqjen e vetos bullgare në negociatat për anëtarësim në BE, i perceptuar si kërcënim për identitetin kombëtar maqedonas, por edhe falë një bilani katastrofik në politikën e brendshme, në të gjitha nivelet.
- Për VMRO-DPMNE-në, zgjedhjet e Tetovës ishin mundësia për të konfirmuar epërsinë e supozuar si të madhe ndaj LSDM-së, statusin e saj si pushteti i ardhshëm dhe liderin i saj si kryeministër i ardhshëm. Në mënyrë indirekte, VMRO po kërkonte të shkëputet nga historia e saj e bashkëpunimit me BDI-në në kohën e Gruevskit, duke ndërtuar ura me opozitën shqiptare për t'i dërguar mesazhin elektoratit të saj se një koalicion qeveritar pa BDI-në e korruptuar është i mundur.

- Partitë më të vogla shqiptare dhe maqedonase si PDSH, Alternativa, Levica, si dhe Nisma Qytetare “Më mirë për Tetovën” po luftonin që të hynin apo të qëndronin në këshillin komunal dhe të mbeten disi relevante.



Fushata mes partive shqiptare: karakteristikat kryesore dhe çështjet e trajtuara

Fushata u zhvillua nga 29 korriku deri më 18 gusht. Për shkak të rëndësisë simbolike dhe elektorale të Tetovës dhe gjasave për zgjedhje të parakohshme parlamentare, fushata për këshillin lokal mori një karakter tjetër duke shkuar përtej dinamikës lokale. Kjo u manifestua fillimisht në retorikë, me liderët e partive që theksonin vazhdimisht se këto nuk ishin vetëm zgjedhje lokale, por zgjedhje që do të përcaktonin trajektoren e partive të tyre në të ardhmen. Për më tepër, të gjitha partitë i përqendruan resurset e tyre qendrore në fushatë: takime të mëdha, prani e shpeshtë e liderëve të partive si dhe e zyrtarëve të lartë qeveritarë si ministra, drejtorë etj. Tetova u shndërrua në një fushë beteje të demonstrimit të pushtetit dhe forcës.

Është e rëndësishme të theksohet se koha e fushatës nuk ishte e favorshme për asnjë parti për shkak të pushimeve verore dhe temperaturave relativisht të larta. Kjo u konfirmua nga përqindja e ulët e pjesëmarrjes prej 35.31%, apo gati 10% më pak se në zgjedhjet e mëparshme lokale. Megjithatë, pothuajse të gjitha partitë zhvilluan fushata derë më derë dhe mbajtën takime relativisht të mëdha për të demonstruar kapacitetet e tyre mobilizuese.



Megjithatë, duke pasur parasysh pushimet verore, kandidatët kishin mjaft hapësirë për të shpjeguar mesazhet e tyre në media. Në TV21 ka pasur intervista me shumicën e listave, secila me nga tre përfaqësues. Përveç intervistave të listave, TV21 organizoi një debat final me të gjitha partitë në ditën e fundit të fushatës. Edhe TV Koha ka organizuar një sërë debatesh.

Fushata ishte relativisht e qetë dhe pa incidente. Në fund të fushatës, bartësit e listave u ulën për një kafe pas debatit final televiziv.

Bashkimi Demokratik për Integrim

Slogani: “Bashkë për Tetovën”

Bartësi i listës: Faton Ahmeti

Fushata e BDI-së u karakterizua nga tre elementë kryesorë:

1. Pas ristrukturimit të degës së tyre në Tetovë, BDI u distancau paksa nga trashëgimia e Arifit, duke mos e përmendur Teuta Arifin dhe madje duke pranuar disa dështime dhe duke thënë se kanë nxjerrë mësim nga gabimet e së kaluarës;

2. BDI kërkoi nga tetovarët që t'i jepet shumicë në këshill, në mënyrë që të veprojë si kontrolluese ndaj kryetarit të komunës, për të rritur transparencën dhe llogaridhënien;
3. Argumenti kryesor i BDI-së ishte se për shkak të pozitës së saj në pushtetin qendror, do të mund të tërheqë më shumë investime në Tetovë. Për të forcuar këtë argument, qeveria organizoi gjatë fushatës inaugurimin e një investimi të rëndësishëm në Tetovë: një fabrikë për prodhimin e makinave elektrike Next.e.GO Mobile e lidhur me "Ecolog International", një kompani multinacionale e themeluar nga biznesmeni tetovar Nazif Destani.



BDI kishte vënë në shënjestër votuesit e rinj duke organizuar një koncert si takim përmbyllës ku është evidentuar një turmë relativisht e madhe e të rinjve.

Përveç targetimit të qëllimshëm të të rinjve dhe distancimit nga Teuta Arifi dhe ish-kryetarit të degës, Florin Besimi, të cilët nuk ishin shumë të pranishëm gjatë fushatës, kishte një tendencë për të rikthyer figurat më të vjetra që janë ndjerë të marginalizuar pas reformave në Degën e Tetovës.

Një fotografi e Faton Ahmetit me Hazbi Likën, një tjetër ish-kryetar komune i BDI-së me bilan të dyshimtë, si dhe një takim relativisht i madh me "veteranët e BDI-së", treguan për një tendencë të qartë për të pajtuar të dy krahët.

Lëvizja Besa

Slogani: "Shumicë për Tetovën"

Bartësi i listës: Besar Durmishi

Besa zhvilloi fushatë "catch-all", nën temën e përgjithshme "Shumicë për Tetovën" e cila i duhej që të shtynte projektin e tyre përpara pa bllokada. Disa nga iniciativat e Kasamit si asfaltimi i rrugës "Straso Pinxhur" dhe rritja e transparencës në shpenzimet komunale, u promovuan si progres që nuk duhet të ndalet, por të fuqizohet më tej.

Ndërsa Besa po sulmonte praktikën e punësimeve fiktive të BDI-së, Kasami u akuzua gjithashtu se po luante të njëjtën lojë me kontratat e punës për të shpërblyer aktivistët partiakë.

Një element dallues i fushatës së Besës ishte prania e fortë e femrave, diçka që nuk ishte parë më parë ose të paktën jo aq qartë me partitë tjera. Femrat e Besës bënë fushatë të ndarë dhe në grupe të mëdha nëpër rrugët e Tetovës.

Aleanca për Shqiptarët

Slogani: "Jepi zë rinisë"

Bartësi i listës: Abdullah Osmani

Aleanca për Shqiptarët kishte vënë në shënjestër rininë e Tetovës, me një listë të përbërë vetëm nga të rinj, gjysma prej tyre femra.

ASH ishte në një situatë të pafavorshme autjsaderi, duke konkurruar kundër një partie të konsoliduar dhe me burime të shumta si BDI, dhe me Besën e cila me avantazhin e kryetarit të komunës bënte fushatë për shumicë komunale.

Për më tepër, ASH nuk mundi të pozicionohej siç duhet në këto zgjedhje pasi ishte në koalicion me Besën në këshillin komunal në largim dhe për këtë arsye nuk mundi të sulmonte bilanin e Kasamit. ASH zgjodhi të bëjë fushatë kundër BDI-së dhe trashëgimisë së Arifit, por shpejt humbi vëmendjen e tetovarëve si forcë jorelevante në garën e ashpër mes Besës dhe BDI-së.

Temat kryesore që trajtoi ASH ishin këto: ndalimi i praktikës së kontratave të punësimit fiktiv nga BDI dhe Besa, ndalimi i migrimit të rinjve që i imputohej keqmenaxhimit të BDI-së dhe ndërtimi i një infrastrukture më të mirë (rrugë, parkingje, shkolla, etj.).

Partia Demokratike Shqiptare

Slogani: “Për kryeqendrën shqiptare”

Bartësi i listës: Visar Palloshi

Mesazhi kryesor i fushatës së PDSH-së ishte një mesazh lokalist, duke u përqendruar në rikthimin e dinjitetit të qytetit të Tetovës dhe tetovarëve.

PDSH zhvilloi një fushatë derë më derë dhe ishte ndoshta partia më aktive në rrugët e qytetit, duke shpërndarë fletushka dhe duke folur me njerëzit. PDSH zhvilloi gjithashtu dy takime relativisht të mëdha dhe përfaqësuesit e tyre u artikuluan relativisht mirë në debate, duke premtuar zgjidhje konkrete për problemet si parkingjet, qentë endacakë etj.

The Alternative

Slogani: “Tetova ka Alternativë”

Bartësi i listës: Faton Selami

Elementi më i dukshëm në fushatën e Alternativës ishte shfaqja e pushtetit, me takime në dukje të mëdha që mbledhën së bashku zyrtarë partiakë nga i gjithë vendi, duke përfshirë ministra, deputetë dhe drejtorë.

Nga ana e përmbajtjes, fushata e tyre u fokusua pothuajse vetëm në projekte të lidhura me infrastrukturën: hapësira kulturore, parqe, shkolla, parkingje, një stadium komunal dhe rrugë më të mira.

Iniciativa Qytetare “Më mirë për Tetovën”

Slogani: “Më mirë për Tetovën”

Bartësja e listës: Elmedina Abdullai

“Më mirë për Tetovën” zhvilloi një fushatë të fokusuar në pikat e mëposhtme:

1. Shoqëria civile kundër partive politike: lista u distanca nga partitë politike duke pretenduar se ata nuk mund të shantazhohen nga financuesit privatë dhe se vendimmarrja e tyre është e pavarur dhe joklientiste;

2. Profesionalizmi: lista promovonte arritjet profesionale të kandidatëve të saj, diçka që gjoja i dallon ata nga aktivistët e partive politike;
3. Përvoja e kaluar: anëtarët e këshillit në largim kishin dhuruan mëditjet e tyre të këshillit për bamirësi dhe kishin siguruar më shumë transparencë duke kërkuar me ngulm që seancat e mbledhjeve të këshillit të transmetohen online.


Megjithatë, entuziazmi që rrethoi “Më mirë për Tetovën” në zgjedhjet e 2021 u zbeh shpejt, pjesërisht sepse edhe ata u humbën në betejën BDI-Besa, por edhe sepse argumentet e tyre për transparencë dhe progres u përvetësuan nga Kasami, i cili është dëshmuar konstruktiv dhe ka luftuar të njëjtën betejë.



Rezultatet: fitore dhe humbje të (pa)pritura

Një nga sondazhet e rralla, nëse jo i vetmi i publikuar para zgjedhjeve të jashtëzakonshme lokale në Tetovë, ishte ai nga Qendra për Hulumtime dhe Komunikim Politik. Sipas këtij sondazhi synimet e votimit ishin: Besa 19,7%, BDI 17,35%, VMRO-DPMNE 9,4%, SDSM 7,1%, Iniciativa Qytetare “Më mirë për Tetovën” 5,55%, Levica 4,95%, Aleanca për Shqiptarët 3,75%, PDSH 1.45% dhe Alternativa 1.45%.


Për cilën listë partiale do të votoni në zgjedhjet e ardhshme të këshillit më 20 gusht?




Burimi: CRPC, gusht 2022

Siç ndodh shpesh me sondazhet, rezultatet përfundimtare morën megjithatë një kahje relativisht të ndryshme.

Lëvizja Besa i fitoi zgjedhjet, por ajo mori 9,620 vota apo 34% të votave. Besa pasohet nga BDI, i cila gjithashtu ishte dukshëm mbi pritshmëritë me 31%. Tronditja e këtyre zgjedhjeve ishte ASH e cila mori vetëm 777 vota ose 3%. VMRO-DPMNE (12%) ka një epërsi të rehatshme ndaj LSDM-së (7%), por që është e krahasueshme me rezultatet e vitit 2021.




Konvertuar në mandate, Lëvizja Besa kryeson me 12 këshilltarë. E radhës është BDI me 11 këshilltarë, pasuar me VMRO-DPMNE me 4, LSDM me 2, Alternativa me 1 dhe PDSH me 1 poashtu. Aleanca për shqiptarët dhe “Më mirë për Tetovën” e udhëheqin Këshillin komunal. Ky konfigurim e vendos Bilall Kasamin në një rrugë të mirë për të krijuar shumicë të qëndrueshme me VMRO-DPMNE-në, duke mos pasur nevojë për mbështetjen e partive qeveritare.



DALJA E VOTUESVE

Pjesëmarrja ishte 35.31%, me 29,690 vota të shrehura në total, apo 8,860 vota më pak krahasuar me zgjedhjet lokale të vitit 2021. Si pasojë, të gjitha listat pësuan ulje të numrit të votave, përveç Lëvizjes Besa e cila shënoi rritje prej 15% krahasuar me vitin 2021. Rënia më e madhe u vu re nga ASH (80%, ose 3,135 vota) që ishte një rezultat katastrofik për partinë më të madhe opozitare shqiptare. Tabelat e

mëposhtme japin rezultatet e partive politike gjatë viteve 2017-2022 dhe ndryshimet në vota që nga zgjedhjet e vitit 2021.



Partia/viti	2017	2021	2022	Dallimi 2021-2022	Dallimi në vota
BDI	10,736	10,114	8,702	-14%	(1,412)
Besa	7,052	8,367	9,620	15%	1,253
ASH	4,512	3,912	777	-80%	(3,135)
PDSH	4,143	2,526	1,058	-58%	(1,468)
Alternativa			1,118	?	?
Më mirë për Tetovën		2,842	761	-73%	(2,081)
VMRO	5,903	4,062	3,332	-18%	(730)
SDSM	4,123	2,672	1,953	-27%	(719)
Levica		907	646	-29%	(261)



Përfundim: mësimet kryesore

Zgjedhjet e Tetovës të 20 gushtit vërtetë konfirmuan qëndrimet negative të votuesve ndaj pushtetit qendror, por ato ishin shumë më tepër se kaq. Këto zgjedhje ishin një tërmet me implikime serioze në nivel republikan.

BDI luajti dhe humbi. Për herë të parë në historinë e saj, partia e Ali Ahmetit, e cila rasti të ketë selinë në Tetovë, nuk është më partia e parë në këshillin komunal. Duket se BDI-ja e ka humbur definitivisht rajonin e Pollogut, rezervuarin më të madh të votave shqiptare në Maqedoninë e Veriut: nga nëntë komunat e Pollogut, BDI aktualisht ka vetëm dy komunat rurale: Bogovinën dhe Tearcën. Dy qendrat urbane, Tetova dhe Gostivari drejtohen respektivisht nga Besa dhe Aleanca për Shqiptarët. Nëse është e vërtetë që Pollogu bën dhe prish të ardhmen partive politike shqiptare, atëherë duket se shqiptarët janë të gatshëm të dërgojnë BDI-në në opozitë.

Besa është pa dyshim fituesja më e madhe e këtyre zgjedhjeve. Partia konfirmon Tetovën, qytetin e liderit të saj, si bastionin e saj dhe e profilizon veten si një forcë serioze me të cilën duhet llogaritur në kampin shqiptar, ndërsa partitë përgatiten për zgjedhje të parakohshme parlamentare.

Goditjen më të madhe të zgjedhjeve në Tetovë e ndjeu Aleanca për Shqiptarët, pa dyshim humbësja më e madh. Rënia e partisë në këto zgjedhje, e cila për herë të parë nuk do të përfaqësohet në këshillin komunal të Tetovës, çoi brenda 24 orëve në dorëheqjen e kryetarit të saj, Ziadin Sela. Partia ka njoftuar se do të nisë një garë lidershipe dhe një ristrukturim tjetër vetëm 5 muaj pas zgjedhjes së Selës si kryetar dhe 2 muaj pas konstituimit të degëve të saj lokale.

Në mesin e humbësve është edhe SDSM e kryeministrit Kovačevski, e cila humbet 27% të votave në krahasim me vitin e kaluar, duke konfirmuar trendin rënës të një partie që ka mbajtur pushtetin qendror gjithmonë si humbëse dhe vetëm falë mbështetjes nga partitë shqiptare.

VMRO-DPMNE është fituesi tjetër i këtyre zgjedhjeve dhe mesazhi nga lidershipe i saj ka qenë i qartë: fitore e dyfishtë VMRO-Besa kundër qeverisë, duke lënë të kuptohet për rritjen e bashkëpunimit mes dy partive drejt formimit të qeverisë së ardhshme.



ARBËN
XHAFERI 
Institute of Public Policy

Dame Gruev nr. 7/8/3
1000 Shkup

Republika e Maqedonisë së Veriut

Phone: +389 2 522 2922

E-mail: info@ipp-arbenxhaferi.org

Web: www.ipp-arbenxhaferi.org

